

Klinika mund të kontaktohet çdo ditë nëpërmjet telefonit, nga ora 9.00 deri në orën 16.30. Jashtë kësaj kohe mund të konsultoheni me një mjek nëpërmjet shërbimit kujdestar për mjekësi familjare.

Anonimiteti

Mjeku juaj i familjes dhe enti për sigurim shëndetësor nuk do të njoftohen për trajtimin tuaj në klinikën tonë. Juve do t'ju jepet një letër me informacione lidhur me trajtimin tuaj. Këtë mund t'ia/ua jepni vetë mjekut apo mjekëve tuaj të familjes.

Kontrulli i mëtejshëm

Duhet që pasi të kalojnë 4 javë të bëhet kontrulli për të vërtetuar se trajtimi ka qenë i suksesshëm.

Këtë kontroll mund ta bëjë mjeku juaj i familjes, ose një nga mjekët e klinikës sonë.

Duhet që në çdo rast të bëhet një test i shtatzënisë për të vërtetuar se nuk është më i pranishëm hormoni i shtatzënisë.

Pasi të kalojnë 3 javë nga trajtimi testi i shtatzënisë ende nuk ka kuptim sepse atëherë hormoni i shtatzënisë është akoma i pranishëm.


Në rast se më pas ju paraqiten probleme përballimi shpirtëror, ju këshillojmë që të kontaktoni me klinikën tonë ose me mjekun tuaj të familjes. Këto probleme mund të paraqiten edhe kohë të gjatë pas trajtimit Edhe atëherë këshillohet të kërkohet ndihmë.

Në fund duhet të theksojmë se në rast të ndonjë ankese duam që të na njoftoni. Ankesën mund t'ia drejtoni klinikës apo me shkrim komisionit për ankesa. Për adresën shikoni tabelën për lajmërimë në dhomën e pritjes.

Shpenzimet

Ndërprerja e shtatzënisë është pa pagesë nëse banoni në Holandë. Shpenzimet mbulohen nga fondi për shpenzime të posaçme mjekësore [AWBZ].

Nëse nuk banoni në Holandë, informacionet në lidhje me shpenzimet mund t'i merrni nga klinika.



QENDRA PËR SHËNDET SEKSUAL HOLANDË VERIORE STIMEZO/ SGNN

Radesingel 11,9711 ED Groningen
tel: (050) 313 22 50
www.csgnn.nl

Më tepër informacione mund të gjeni në faqen tonë të internetit: www.csgnn.nl

Nëse jeni shtatzënë dhe nuk doni që shtatzëninë ta mbani deri në fund, ekziston mundësia që t'ju bëhet dështim (abort) i nxitur (abortus provocatus). Në klinikën tonë ky trajtim mund të bëhet deri 13 javë duke llogaritur nga dita e parë e menstruacionit të fundit.

Deri 16 ditë vonesë (numri i ditëve që është vonuar menstruacioni) vini në konsiderim për trajtim për arsye vonimi = dështim (abort) i hershëm pa kohë për të menduar, që parashihet me ligj.

Ky trajtim është zakonisht i mundshëm nga dita e dymbëdhjetë e mosardhjes (vonesës) së menstruacionit.

Në rast se **menstruacioni ju është vonuar më gjatë se 16 ditë** Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë [Wet Afbreking Zwangerschap] kërkon 5 ditë "**afat për të menduar**" nga dita e bisedës së parë me një mjek ku keni shqyrtuar qëllimin tuaj për ndërprerjen e shtatzënisë deri te dita e trajtimit. Për bisedë të tillë dhe për fletë udhëzimi mund të caktoni një takim me mjekun tuaj të familjes ose me klinikën tonë.

Menjëherë pas kontaktit të parë me mjekun e familjes ose me ne mund të caktojme një datë për trajtimin.

Në rast se keni një takim të caktuar për trajtim dhe para asaj dite keni gjakderdhje, ju këshillojmë që të na telefononi për këshilla të mëtejshme.

Trajtimi

Te **kyretazhi me thithje** mitra zbrazet me një tub të hollë që nëpërmjet vaginës futet në hapësirën e mitrës. Nuk ju jepet narkozë e përgjithshme por vetëm anestezi lokale. Trajtimi zgjat rreth 10 minuta nga të cilat 2 minuta me ngërçe. Këta zakonisht largohen shpejt pas trajtimit. Në dhomën e pushimit do të qëndroni rreth gjysmë ore nën kontroll.

Lidhur me detajet e metodës së trajtimit do të njoftoheni më hollësisht në klinikë dhe mund të konsultoni edhe faqen tonë të internetit.

Biseda paraprake dhe ekzaminimi

Pas aritjes dhe regjistrimit tuaj zhvillohet një bisedë me një mjek/infermier ku shqyrtohet vendimi juaj dhe ju jepen informacione lidhur me metodat e mundshme të trajtimit. Ju mund të bisedoni për të gjitha pyetjet që keni dhe pastaj të vendosni nëse do të vazhdoni me trajtimin apo jo dhe nëse vazhdoni, në çfarë mënyre.

Do t'i kushtohet vëmendje mjetit kontrceptiv

që dëshironi në të ardhmen. Spiralja (zakonisht) mund të vendoset menjëherë pas kyretazhit.

Për të përcaktuar moshën e saktë të shtatzënisë mjeku do të bëjë një ekzaminim ekoskopik (vaginal) si edhe një ekzaminim të brendshëm.

Në rast se shtatzënia ende nuk mund të shihet (mirë) trajtimi shtyhet me 1-2 javë.

Në rast se trajtimi nuk mund të kryhet në klinikën tonë apo vendosni që shtatzëninë ta mbani deri në fund ose ende nuk jeni e sigurt, ne do t'ju ndihmojmë që të gjeni ndihmën që ju nevojitet.

Çfarë duhet të merrni me vete në klinikë?

- kartelën e vlefshme të sigurimit shëndetësor ose një dokument për të dëshmuar se banoni në Holandë, si p.sh. një ekstrakt nga regjistri i banorëve
- mundësisht një letër nga mjeku i familjes
- mundësisht informacion për grupin tuaj të gjakut
- në rast se dëshironi t'ju bëhet kyretazhi: një këmishë nate apo një bluzë (T-shirt) të gjatë, mbathje (brekë), peceta higjienike (jo tamponë), peshqir dhe dorezë për larje, çorape rezervë ose papuçe (pantofla). Mundësisht diçka për të ngrënë pas trajtimit.

Nëse doni të merrni dikë me vete si mbështetje, kjo patjetër është e mundshme.

Fatkeqësisht në dhomën e pushimit nuk lejohet në asnjë mënyrë shoqërimi nga ndonjë mashkull. Kjo për arsye të jetës private të femrave që ndodhen aty.

Pas trajtimit Në

shtëpi

Nuk këshillohet të ngisni vetë makinën apo biçikletën.

Ju këshillojmë që ditën(t) e trajtimit dhe të nesërmen të mos e mundoni veten dhe gjatë javës së parë t'ju shmangeni punëve të rënda fizike.

Gjakderdhje dhe dhembje barku

Gjakderdhja pas ndërprerjes së shtatzënisë mund të jetë shumë e ndryshme. Mund të jetë shumë më tepër se sa gjatë menstruacionit normal dhe mund të zgjasë shumë. Ndonjëherë nuk ka aspak gjakderdhje ose paraqitet disa javë sekrecion ngjyrë kafe.

Dhembje të ngjashme me dhembjet e menstruacionit janë normale pas trajtimit. Ndonjëherë dhembjet janë të forta. Ju lejohet të përdorni ndonjë barë për qetësimin e dhembjeve (Paracetamol apo Ibuprofen).

Mund të pritni që menstruacioni i parë t'ju vijë 4 deri 6 javë pas trajtimit.

Antibiotikë

Pas trajtimit zakonisht ju jepen antibiotikë për të kufizuar rrezikun nga infeksioni.

Nuk lejohet të bëni:

Gjatë një jave pas kyretazhit me thithje nuk lejohet të përdorni tamponë, të keni marrëdhënie seksuale vaginale dhe të notoni në pishinë apo të bëni banjë (lejohet të bëni dush).

Mjetet kontrceptive

Nëse keni vendosur të përdorni pilulën kontrceptive, nëse ju bëhet kyretazhi duhet që atë të filloni ta përdorni në ditën e trajtimit. .

Ankime shtatzënie

Neveria (ndjenja e vjelljes) dhe ndjenja e tendosur në gjinj zhduken pas disa ditë.

Kini parasysh se si pasojë e ndryshimit të menjëhershëm hormonal, mund të paraqitet ndjenjë apatie, ndryshueshmërie ose lodhjeje.

Situata jonormale

Ju këshillojmë që të kontaktoni me klinikën tonë ose me mjekun tuaj të familjes:

- në rast se ju paraqiten gjakderdhje të mëdha ose ndjeni më shumë dhembje barku nga ato që i ndjeni normalisht gjatë menstruacionit.
- nëse keni rritje të temperaturës mbi 38.5 0C